



**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Firma Pastruese “Bajraktari” ShPK, me numër të biznesit 810695306 me seli në Vushtrri, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Palushi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.120/22 të datës 21.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.120/22 të datës 21.11.2023, vërtetohet.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e ankimuar KA.nr.120/22 të datës 21.11.2023, Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Bajraktari” ShPK. Anulohet vendimi PSH.nr. 734/18 i datës 04.02.2018 i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit. Nën pikën II. të dispozitivit, Ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën III. Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, paditësi udhëzohet në procedurë kontestimore. Ndërsa, nën pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit Organit Shqyrtues i Prokurimit, se e bazuar ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.120/22 i datës 21.11.2023 pika I. e dispozitivit të anulohet dhe njëherit të mbetet në fuqi vendimi i Panelit Shqyrtues të OSHP-së PSH.nr.734/18 i datës 04.02.2019.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

## **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, PSH nr.734/18 i datës 04.02.2019, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Bajraktari”-Vushtrri lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi, rregullimi dhe riparimi i Rrugëve dhe trotuareve, financim nga Buxheti si dhe bashkëfinancim me qytetar” me nr. prokurimit: 642/18/022/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Mitrovicë. Në pikën II të dispozitivit Vërtetohet, Njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Ndërtimi , rregullimi dhe riparimi i Rrugëve, trotuareve, financim nga buxheti dhe bashkëfinancim me qytetar” me nr. prokurimit 642/18/022/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Mitrovicë. Në pikën III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet të informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në pikën IV të dispozitivit, mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, të Ligjit 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Në pikën V. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankesë “Bajraktari”-Vushtrri, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Në pikën VI. Obligohet operatori ekonomik ankesë që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 08.03.2019, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar duke e anuluar vendimin lartcekur. Me arsyetim se gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, në procesverbalin e datës 21.11.2022 e ka obliguar të paditurin që për OE fitues “Bageri” ShPK të dorëzoj dosjen e tenderit, mirëpo pavarësisht detyrimit e paditura as në përgjigje në padi e as në seancën e shqyrtimit kryesor të obliguar sipas procesverbalit të datës 21.11.2022, nuk ka ofruar dosjen e tenderit. Gjykata ka vlerësuar se për shkak të mos dorëzimit të provave që janë nxjerrë në procedurë administrative, nuk është arritur që të vërtetohet si e drejtë gjendja faktike e konstatuar nga i padituri në procedurë administrative kur ka refuzuar ankesën e paditësit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi, rregullimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve financim nga buxheti si dhe bashkëfinancim qytetar” të iniciuar nga AK, Komuna e Mitrovicës, për shkak se paditësi përmes provave të dorëzuara ka dëshmuar se ka qenë i përgjegjshëm ndërsa i padituri nuk ka vepruar sipas vendimit të gjykatës për sjelljen e kopjes së dosjes së tenderit. Nga raporti i ekspertit shqyrtues i datës 04.01.2019, gjykata ka konstatuar se në lidhje me aktivitetin e Prokurimit “Ndërtimi, rregullimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve financim nga buxheti dhe bashkëfinancim qytetar” me nr. të prokurimit 642/18/022/511 i padituri ka caktuar ekspertin shqyrtues për hartimin e raportit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit i cili ndër tjera ka konstatuar se lidhur me këtë aktivitet prokurimit AK nuk ka vlerësuar ofertat në përputhje me kërkesat e parashtruara për kualifikim dhe në përputhje me kriterin e përcaktuar për vlerësim.

Eksperti shqyrtues ndër të tjera ka konstatuar se arsye e eliminimit të OE “Bajraktari” se i mungojnë referencat e ngjashme nuk qëndron për shkak se vlera e projekteve të realizuara tejkalon shumën 6,000,000.00€ (gjashhtë milion euro). Po ashtu ka konstatuar se vlera e ofertës së dorëzuar nga OE “Bajraktari” është 2,293,900.00€, ndërsa për kontratë është rekomanduar OR shumë më të shtrenjtë, ku si përfundim ka theksuar se OE “Bajraktari” është i përgjegjshëm. Nga raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 24.08.2018, gjykata ka konstatuar se në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi, rregullimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve financim nga buxheti si dhe bashkëfinancim qytetar” me numër të prokurimit 642/18/022/511 kanë marrë pjesë njëmbëdhjetë (11) OE. Ndër të tjera është konstatuar se OE “Bageri” plotëson kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe rekomandohet për nënshkrim të kontratës ndërsa OE “Bajraktari” nuk i plotëson kërkesat për mundësitë teknike pasi që nuk posedon pajisjet e kërkuara sipas dosjes së tenderit. Gjykata vlerësoi se përkundër mungesës së dosjes së tenderit përmes së cilës do të mundësohej vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike, gjen se aprovimi i kërkesëpadisë së paditësit është i nevojshëm me qëllim të mbrojtjes së integritetit të procesit gjyqësor, ligjshmërisë së akteve administrative dhe shmangies së situatave ku i padituri mund të shfrytëzojë mungesën e provave për të shmangur përgjegjësinë apo të pengoj vërtetimin e fakteve në dëm të paditësit. Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, gjykata ka vepruar konform nenit 46 par. 5 të LKA-së, pasi që provat në këtë çështje nuk kanë dhënë bazë të sigurt për caktimin e dëmit, ashtu që gjykata paditësin e udhëzoi që kërkesën për kompensim të dëmit ta realizojnë në procedurë kontestimore.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar provat dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Përkundër se aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Dhoma e Shkallës së Parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës në ankesë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që e paditura ka konstatuar se në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale janë kërkuar një numër i pajisjeve për të cilat si dëshmi janë kërkuar faturat e blerjes, DUD, librezat e qarkullimit, kontratë mbi qiramarrje etj, por nuk janë kërkuar që librezat e automjeteve të kenë validitet qarkullimi, madje edhe të ishte si kërkesë e dosjes së tenderit një kërkesë e tillë nuk do të konsiderohej e arsyeshme dhe të përdorej si argument për eliminim, po ashtu OE i rekomanduar posedon pajisje të cilave ju ka skaduar afati i regjistrimit sepse regjistrimi për qarkullim është i nevojshëm për daljen e automjeteve në rrugë. Paneli shqyrtues ka konstatuar se asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet pa ndonjë kërkesë që nuk është parashikuar në dosjen e tenderit dhe tek njoftimi për kontratë. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, meqë Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerr prova të mjaftueshme të

cilat vërtetojnë se e paditura nuk ka arsyetuar fare pretendimet e paditësit por vetëm ka përshtetur kronologjinë e ngjarjes, po ashtu Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referuar nenit 37 paragrafi 3 të LKA-së ka vendosur për çështjen në mungesë të shkresave të lëndës pasi që me provat e administruara nuk arriti të konstatoj si të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në procedurë administrative, andaj e anuloi vendimin PSH.734/18 të datës 04.02.2018 të nxjerrë nga i padituri me të cilin është vërtetuar njoftimi për dhënien e kontratës AK në aktivitet prokurimi “Ndërtimi, rregullimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve financim nga buxheti si dhe bashkëfinancim qytetar”. Kolegji konstatoj se nuk është provuar ndryshe nga e paditura në asnjë fazë të procedurës të këtij konflikti administrativ. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes. Prandaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes edhe të kolegjit të kësaj gjykate e bënë të pa qëndrueshëm arsyetimin e vendimit kontestues. Ngase në arsyetim të vendimit të kontestuar është dashur të vlerësohen pretendimet e paditësit që kanë rëndësi vendimtare në mënyrë që të jepen sqarime bindëse.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë ka pasur në dispozicion ankesën, kërkesën për rishqyrtim, dy vendimet lidhur me këtë procedurë të prokurimit, nga ka mundur që të bëjë analizimin e aktivitetit të prokurimit, e jo të vendos për anulimin e aktit në mungesë të shkresave sikurse ka vendosur. Andaj Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka vlerësuar provat e administruara, dhe po ashtu gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës. Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë, pasi që i padituri nuk ka provuar me asnjë provë të vetme pretendimin për eliminimin e paditësit për shkak të mos plotësimit të kushteve, ku në këtë rast paditësi ka paraqitur dëshmitë siç janë projektet e përfunduara të ngjashme ndërtimore në tri vitet e fundit në vlerë monetare 6,000,000.00€ (gjashtë milion euro) e cila dëshmi parashihej të paraqitet me rastin e aplikimit për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi, rregullimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve financim nga buxheti si dhe bashkëfinancim qytetar” Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij ndërsa, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, gabimisht vlerësoi provat e administruara po ashtu gabimisht aplikoi edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditurit.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.52/24, me datë 24.05.2024**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**